

L I G J
Nr.9162, datë 18.12.2003

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7928, DATË 27.4.1995 "PËR
TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR", I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Pas pikës 1 të nenit 3 shtohet pika 1/l me këtë përmbajtje:

"1/l. Personi i tatueshëm, shitës mallrash me shumicë, detyrohet të kërkojë të regjistrohet edhe në rastet kur qarkullimi i tij vjetor nuk e kalon kufirin minimal të regjistrimit, i parashikuar në pikën 4 të këtij neni."

Neni 2

Pas pikës 2 të nenit 20 "Toka dhe ndërtesat" shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

"3. Dhënia me qira e ndërtesave pronë publike nga organet e pushtetit qendror ose vendor është furnizim i përjashtuar."

Neni 3

Pas nenit 24 shtohet neni 24/l me këtë përmbajtje:

"Neni 24/l

Furnizimi i shërbimeve arsimore nga institucionet arsimore publike dhe private, në përputhje me ligjin nr.7952, datë 21.6.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar" dhe ligjin nr.8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", është furnizim i përjashtuar."

Neni 4

Shkronja "a" e pikës 4 të nenit 26 ndryshohet si më poshtë:

"a) shpenzimet e transportit e të sigurimit dhe shpenzimet e tjera, të përfshira në importimin e mallrave dhe livrimin e tyre, deri në çastin e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë;"

Neni 5

Në nenin 26/l pas shkronjës "d" shtohet shkronja "dh" me këtë përmbajtje:

"dh) importimi i kafshëve të gjalla të racës, të dhuruara nga donatorë të ndryshëm."

Neni 6

Pas pikës 3 të nenit 28 "Detyrimet mbi furnizimet" shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

"4. Për mallrat, të cilat pësojnë humbje gjatë tranzitimit, magazinimit dhe prodhimit, siç

përcaktohet në akte të veçanta ligjore dhe nënligjore, nuk llogaritet dhe nuk paguhet TVSH-ja."

Neni 7

Në nenin 36 bëhen këto shtesa dhe ndryshime.

1. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

"1/1. Në fund të faturës shënohet blerësi me emër, mbiemër, nënshkrim, transportuesi me emër, mbiemër, nënshkrim dhe shitësi me emër, mbiemër, nënshkrim dhe vulë. ".

2. Pas shkronjës "b" të pikës 2 shtohet shkronja "b/1" me këtë përmbajtje:

"b/1) emrin, adresën dhe NIPT-in e transportuesit, targën e mjetit dhe orën e furnizimit."

Pas pikës 7 shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:

"8. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, sipas kritereve të përcaktuara me udhëzim nga Ministri i Financave, ka të drejtë të autorizojë personat e tatueshëm, që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e përpunimit të qumështit, përpunimit të ullirit, përpunimit të rrushit dhe të bluarjes së grurit, të lëshojnë fatura tatimore për veten, për sasinë e qumështit, të ullirit, të rrushit dhe të grurit, me të cilën janë furnizuar nga persona të tjerë të paregjistruar për tatimin mbi vlerën e shtuar."

Neni 8

Në fund të pikës 7 të nenit 42 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

"Mosdërgimi i njoftimit për rezultatet e rishqyrtimit nga organet tatimore, brenda afatit 30-ditor, vlerësohet si përgjigje në favor të personit të tatueshëm. ".

Neni 9

Në fund të nenit 52 shtohen fjalët "sipas afateve dhe rregullave të përcaktuara në ligjin nr.9160, datë 18.12.2003 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4079, datë 28.12.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**